

SELIME BREGU



Audituese e Lartë, Departamenti i Auditimit të Pushtetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm. Lindur në vitin 1964. Diplomuar në Ekonomi Agrare(1986)

Vjetërsia në punë 27 vite, nga të cilat 15 vitet e fundit në KLSH. Audituese e Lartë nga muaji mars 2013. Eksperienca: Auditim financiar.

AUDITIMI SUPREM DHE ÇERTIFIKIMI I LLOGARIVE¹

nga Selime Bregu

Auditimi, në një farë mënyre, që në zanafillën e tij çertifikonte bilancet, duke dhënë një opinion nëse “pasqyrat financiare” të audituara si një e tërë kanë ose nuk kanë evidencë të padeklaruar ose siç themi sot, gabime materiale në një masë “sigurie të arsyeshme”. Ne realitet, edhe sot, krahas auditimit të performances se institucionit publik që auditohet, objekti kryesor i veprimtarisë së Auditimit të Jashtëm Suprem publik është testimi i transaksioneve historike financiare, ekzaminimi i pasqyrave financiare dhe çertifikimi i bilancit mbi veprimtarinë ekonomiko - financiare vjetore. Veprimtaria e auditimit të jashtëm për sektorin publik në çdo shtet drejtohet dhe realizohet nga institucioni më i lartë i kontrollit në vend. Këto institucione zakonisht quhen me një emër të përgjithshëm “Institucione Supreme të Auditimit” (Supreme Audit Institutions-SAI). Veprimtaria e tyre mbështetet në aktet ligjore të çdo vendi (zakonisht Ligji themeltar i shtetit, pasi përfaqësojnë një institucion kushtetues), në statutin e tyre dhe në standardet ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm.

Emërtimi i institucioneve të Auditimit të Jashtëm për secilin shtet i referohet traditës dhe mënyrës së organizimit të këtij shërbimi. Kështu tek ne në Shqipëri e quajmë *Kontrolli i Lartë i Shtetit*. Në disa nga vendet e tjera të botës Auditimi i Jashtëm është i organizuar si më poshtë:

- Me emërtimin: “Zyra Kombëtare e Auditimit” (*National Audit Office-NAO*) në Angli, Australi, Kinë, Finlandë, Hungari, Latvi, Lituani, Maltë, Qipro, Serbi, Maqedoni dhe Kroaci.
- Me emërtimin: “Gjykata e Llogarise ose Gjykata e Auditimit” në Bashkimin Europian, Austri, Belgjikë, Brazil, Francë, Greqi, Itali, Luksemburg, Moldavi, Slloveni, Spanjë, Turqi, Rumani, Portugali, etj.
- Me emërtimin: “Zyra Qeveritare e Kontabilitetit ose Federata e Kontabilistëve” në SHBA, Rusi dhe Ukrainë.
- Me emërtimin “Zyra e Kontrollorëve dhe Audituesve të Përgjithshëm” në Indi, Irlandë, etj.
- Me emërtimin: “Zyra e Audituesve të Përgjithshëm” në Kosove, Suedi, Skoci, Bosnje & Hercegovinë, etj.

Në vitin 1953 në Havana të Kubës u themelua “*Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit*” - INTOSAI (The International Organization of Supreme Audit Institutions), e cila përfaqëson komunitetin mbarëbotëror të institucioneve të auditimit suprem. Në momentin fillestar të themelimit moren pjesë 34 institucione të auditimit të cilat përfaqësojnë grupin origjinal të formimit. Që nga ajo kohë e deri në vitin 2013, anëtarësia e kësaj organizate përfshin 193 anëtarë, nga të cilat 188 janë institucione kombëtare të auditimit të jashtëm sipas shteteve, 1(një) është Gjykata Evropiane e Auditorëve dhe 4 janë shoqata profesionale të anëtarësuar.

Që nga koha e themelimit e deri në ditët e sotme INTOSAI, *Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit*” ka luajtur rolin

kryesor lidhur me publikimin e standardeve ndërkombëtare për Auditimin e Jashtëm në sektorin publik, te quajtura ISSAI. Krahas orientimeve për auditimin e performances, këto standard vendosin rregullat për auditimin e rregullshmërisë (pajtueshmerise), si dhe auditimin mbi raportimin financiar dhe zbatimin e buxhetit të Shtetit. Auditimi i sistemit financiar dhe të kontabilitetit synon që të sigurojë një evidencë të mjaftueshme për të përcaktuar nëse pasqyrat financiare janë përgatitur:

- Pa anomali (gabime materiale)
- Në përputhje me legjislacionin përkatës
- Në përputhje me standardet e kontabilitetit

Pas sigurimit të kësaj evidence Audituesi i Jashtëm çertifikon bilancin dhe përgatit një raport që përmban një shprehje të qartë të opinionit të tij mbi pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë një paraqitje e strukturuar e pozicionit financiar dhe performancës financiare të një njësie ekonomike. Objektivi i pasqyrave financiare për qëllime të përgjithëshme është të sigurojnë informacion lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike. Pasqyrat financiare tregojnë gjithashtu dhe rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin e burimeve që u janë besuar institucionit publik. Pasqyrat financiare janë fokusi i auditimit dhe audituesit tanë duhet të familjarizohen me këto pasqyra në fillim të çdo auditimi. Pasqyrat financiare zakonisht përgatiten duke vënë në zbatim një nga tri bazat:

- Kontabiliteti i thjeshtë (fatura dhe pagesa)
- Kontabilitet i moderuar (pjesëshëm) i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara
- Kontabilitet i plotë i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Çështjet që audituesit duhet të shqyrtojnë do të ndryshojnë në varësi të bazave të kontabilitetit për pasqyrat financiare, por mund të përfshijnë:

- Përshtatshmërinë e politikave të adoptuara të kontabilitetit, duke iu referuar disa subjekteve të caktuara, standarteve të raportimit financiar dhe urdhrave e udhëzimeve të nxjerra;
- Ndikimi i çdo udhëzimi apo urdhri të ri për kontabilitetin;
- Gjëndjet të cilat kërkojnë një gjykim apo vlerësim domethënës nga ana e institucionit.

Rëndësia e pasqyrave financiare ka sjellë që amendimet e ligjit organik të KLSH, të përpunuara nga KLSH me ndihmën e DG-Budget dhe SIGMA, të parashikojnë edhe fitimin e mandatit ligjor nga KLSH për të dhënë opinionin mbi pasqyrat financiare të institucioneve publike që auditon. Ky tagër i ri ligjor e pajis KLSH me mundësinë për të verifikuar plotësisht:

*ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni i audituar.

ⁱ Botuar në gazetën "Ekonomia" datë 02 korrik 2013.